


Siguri

Ndalet nga Policia e Gjakovës në pikë kontrolli, 50-vjeçari përfundon nën hetim për armëmbajtje



Sinjali.com

27 Korrik 2026 22:07



Një 50-vjeçar ka përfunduar nën hetim në Gjakovë, pasi gjatë një kontrolli rutinë nga Policia iu gjet një armë zjarri në automjet.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se bëhet fjalë për A.T. (50 vjeç).

Sipas informacioneve, rasti ka ndodhur dje rreth orës 22:00 në fshatin Osek Hylë, derisa njësia e Trafikut Rajonal të Gjakovës ishte duke zhvilluar kontroll rutinë të automjeteve.

Gjatë ndalimit, zyrtarët policorë e kanë pyetur drejtuesin e automjetit nëse posedonte ndonjë send të paligjshëm. Fillimisht ai është përgjigjur se nuk kishte asgjë ilegale, por pasi u pyet për çantën që ndodhej në ulësen e pasagjerit, ai ua ka paraqitur policëve një armë zjarri, duke deklaruar se për të posedonte leje përkatëse.

Pavarësisht kësaj, Policia e ka shoqëruar në Stacionin Policor në Gjakovë, ku është intervistuar, ndërsa arma, dy karikatorë dhe fishekët janë sekuestruar.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa Avni Thaqi është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera